



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 155 dt.29.11.1995

Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot më dt.29.11.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë mbi ndarjen administrative të qytetit të Tiranës me blloqe dhe caktimin pranë çdo blloku të një kujdestari.

VENDOSI

1. Të aprovojë strukturën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë për ndarjen e territorit të Tiranës me blloqe dhe caktimin pranë çdo blloku të një kujdestari.
2. Numri i kujdestarëve të jetë 150.
3. Shpërblimi mujor i kujdestarëve të jetë 2.500 lekë.
4. Efektet financiare të përballohen nga të ardhurat e Bashkisë.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Administrimit Financiar dhe Seksioni Personelit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA